Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 13 dhjetor 2013

Lënda nr. 41/09

R. A.

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 13 dhjetor 2013,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga

Z. Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në pajtim me rregullën 13 § 2 të Rregullores së punës, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 27 mars 2009 dhe është regjistruar më 30 mars 2009.

2. Më 21 maj 2009, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesi. Ankuesi është përgjigjur më 8 qershor 2009.

3. Më 25 shtator 2009, Paneli kërkoi informata nga prokurori publik i qarkut në Prishtinë. Paneli pranoi përgjigjen e tij më 9 tetor 2009.

4. Më 30 tetor 2009, Paneli e njoftoi për ankesën Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesës.

5. PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut më 23 nëntor 2009.

6. Më 13 janar 2010, Paneli ia përcolli komentet e PSSP-së ankuesit dhe e ftoi atë të japë komente shtesë nëse dëshironte ta bënte këtë.

7. Komentet shtesë nga ankuesi janë pranuar më 15 shkurt 2010.

8. Më 30 nëntor 2010, Paneli e rinjoftoi me ankesën PSSP-në lidhur me dhënien e komenteve mbi pranueshmërinë e ankesës, në dritë të komenteve shtesë të pranuara.

9. Më 26 janar 2011, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

10. Më 12 gusht 2011, Paneli ia përcolli komentet e PSSP-së ankuesit dhe i kërkoi atij të japë kundërkomentet e tij, nëse ka ndonjë.

11. Ankuesi dha përgjigjen e tij më 16 shtator 2011.

12. Më 9 nëntor 2011, Paneli kërkoi informata shtesë në lidhje me rastin nga prokurori publik i qarkut në Prishtinë.

13. Prokurori publik i qarkut është përgjigjur më 14 nëntor 2011.

14. Më 9 dhjetor 2011, Paneli pranoi një kopje të dosjes hetimore nga Zyra e prokurorit publik të qarkut në Prishtinë (ZPPQ). Sipas ZPPQ-së, dosja ishte e plotë.

15. Më 21 dhjetor 2011, Paneli ia ofroi PSSP-së një kopje të dosjes hetimore dhe i kërkoi atij të japë komente shtesë të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë e ankesës.

16. Më 13 janar 2012,PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

17. Më 18 korrik 2012, Paneli mori informata shtesë në lidhje me rastin nga prokurori publik i qarkut në Prishtinë.

18. Më 21 gusht 2012, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

19. Më 7 shtator 2012, Paneli ia përcolli vendimin e vet PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

20. Më 8 tetor 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

II. FAKTET

21. Faktet për lëndën janë vërtetuar duke u bazuar në parashtresat e ankuesit dhe dosjet hetimore që i janë paraqitur Panelit. Në rastin aktual, Paneli pranoi dokumentet hetimore që më parë i kishte mbajtur Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) dhe dosjen hetimore të rastit që ishte mbajtur nga ZPPQ në Prishtinë.

22. Për sa i përket publikimit të informatave që përmbajnë dosjet, Paneli rikujton që UNMIK-u i ka vënë në dispozicion dosjet për hetim për t'u shqyrtuar nga Paneli nën një zotim për konfidencialitet. Në lidhje me këtë, Paneli duhet të qartësojë që megjithëse vlerësimi i dosjes aktuale rrjedh nga një shqyrtim i plotë i dokumentacionit në dispozicion, vetëm informata të limituara që ekzistojnë aty janë publikuar. Prandaj, një përmbledhje e hapave të ndërmarrë hetimorë nga autoritetet e hetuesisë është dhënë në paragrafët në vijim.

23. Ankuesi është xhaxhai i E.A., i cili ishte gjetur i vdekur më 1 shkurt 2006 në banesën e një miku, z. A., në Prishtinë.

24. Në dosjen hetimore tregohet që E.A. kishte arritur në banesën e z. A. në mbrëmjen e 31 janarit të vitit 2006 dhe kërkoi që aty ta kalojë natën. Në mëngjes, rreth orës 10:00, z. A. vërejti që E.A. ishte i sëmurë dhe me sa duket i kërkoi një fqinje, znj. B., ndihmë. Meqë gjendja dukej serioze, ata e thirrën ambulancën. Megjithëse një ekip i ndihmës së parë erdhi shpejt, E.A. tanimë kishte vdekur.

25. Po të njëjtën ditë, disa ekipe të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) vizituan dhe kontrolluan banesën e z. A. SHPK-ja menjëherë hapi një hetim për vdekjen e z. E.A. Po ashtu në të njëjtën ditë, një ekip i mjekësisë ligjore që përfshinte nëpunësit nga Njësia rajonale e mjekësisë ligjore e SHPK-së dhe Zyra e ekzaminuesit mjekësor të ZPZHML të UNMIK-ut, kontrolluan trupin e E.A. dhe dhomën ku ai kishte vdekur. Në raportin e kontrollit të vendit të ngjarjes të ZPZHML-së, i datës 1 shkurt 2006, thuhet se, në mes gjërave tjera, një pako e zakonshme anti-depresivësh "Kantarion" dhe një shishe ngjyrë kafe me pilula të kuqe ishin gjetur në një dollap në dhomë. Në raport gjithashtu thuhet se viktima kishte një "substancë që shkakton vjellje" në gojë dhe disa lëndime në anën e majtë të tëmthit, në fund të vetullës së djathtë, mbi krah dhe duar. Në raport thuhet se vdekja duket të jetë "e dyshimtë". Në të gjithashtu përshkruhen dëshmitë shtesë të mbledhura në vendin e krimit, duke përfshirë mostrat e gjakut dhe urinës, shenjat e gishtërinjve, thonjtë e prerë dhe bishtat e cigareve.

26. Më 1 shkurt 2006, SHPK-ja mori deklarata nga tre dëshmitarë, z. A. znj. B dhe babai i viktimës, dhe paraqiti një kallëzim penal në ZPPQ në Prishtinë.

27. Më 2 shkurt 2006, një autopsi në trupin e E.A. u krye nga ZPZHML e UNMIK-ut, e vetmja agjenci e autorizuar të kryente kontrolle në fushën e mjekësisë ligjore në Kosovë në atë kohë. Në raportin e autopsisë, që u finalizua më 15 mars 2006, thuhet se E.A. kishte vdekur për shkak të "dobësimit akut të frymëmarrjes dhe ënjtjes së madhe pulmonare hemorragjike" e cila me sa duket "ishte për shkak të helmimit". Në raport thuhet se helmimi vdekjeprurës ka më së shumti të ngjarë të ketë ardhur si rezultat i keqpërdorimit të substancave narkotike; ky përfundim u mbështet nga dëshmia e hollësishme, duke përfshirë një substancë pluhur të gjetur në barkun e E.A. dhe prania e "njollave nga lëndimet e qëndrueshme të shkaktuara më parë" të atij lloji që shihen në rastet e keqpërdorimit të drogës. Në raport gjithashtu thuhet se, përveç lëndimeve që kanë rezultuar nga intervenimi terapeutik gjatë periudhës perimortem, trupi nuk kishte "lëndime të freskëta të rëndësishme", apo "dëshmi ose shenja të dhunës" së supozuar kundër E.A. Në raportin e njëjtë, patologu i ZPZHML këshilloi policinë "[t]ë bëjë aranzhime për toksikologji", pasi analiza e tillë mund të konfirmojë shkaktarin e vdekjes.

28. Ankuesi deklaron se mes shkurtit dhe fillimit të marsit të vitit 2006, ai iu ankua patologut se raporti i autopsisë ishte tepër i përgjithshëm. Thuhet se patologu e informoi atë se të gjeturat e raportit mund të qartësohen vetëm përmes analizës toksikologjike, e cila duhej të bëhej në një laborator jashtë Kosovës, prandaj kjo kërkonte kohë.

29. Më 19 mars 2006, prokurori publik përgjegjës për rastin nga ZPPQ në Prishtinë, i kërkoi SHPK-së që të mbledhë informata në lidhje me vdekjen e E.A. Në veçanti, ai kërkoi që mostrat dhe dëshmia tjetër e mbledhur të ekzaminohen si dhe të merren në pyetje dëshmitarët e mundshëm.

30. Më 27 mars 2006, SHPK-ja ia ofroi prokurorit informatat e azhurnuara mbi hetimin dhe potencoi se shkaktari i vdekjes do të mund të përcaktohej qartë vetëm përmes analizës toksikologjike.

31. Më 31 mars 2006, prokurori përsëri iu drejtua SHPK-së me kërkesën e njëjtë për të mbledhur informata shtesë, si në kërkesën e datës 19 mars 2006.

32. Mes datës 6 dhe 23 maj të vitit 2006, SHPK-ja intervistoi tre persona, dokumentet e të cilëve ishin gjetur në posedim të E.A. Megjithatë, këto intervista nuk ofruan asnjë pistë të re të hetimit.

33. Më 15 gusht 2007, ankuesi i kërkoi prokurorit publik të qarkut në Prishtinë t'ia ricaktojë këtë rast një prokurori ndërkombëtar. Ankuesi pohoi se prokurori përgjegjës për rastin ishte duke e vonuar me qëllim hetimin dhe kishte një sjellje "arrogante" ndaj ankuesit. Në dosje nuk pasqyrohet asnjë veprim për sa i përket kësaj kërkese.

34. Më 15 tetor 2007, prokurori publik përgjegjës për rastin nga ZPPQ në Prishtinë i dërgoi kërkesë tjetër për hetim shtesë SHPK-së, me përmbajtjen e njëjtë si ajo në dy kërkesat e mëparshme të 19 dhe 31 marsit të vitit 2006 (shih§§ 29 dhe 31 më lart).

35. Më 5 dhjetor 2007, SHPK-ja intervistoi z. A, si të dyshuar në lidhje me veprën e cilësuar si ndihmë për përvetësim apo përdorim të substancave të rrezikshme narkotike, substancave psikotropike apo analoge, në pajtim me nenin 231 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Z. A deklaroi që E.A. kishte përdorur gjerësisht antidepresivë, por e hodhi poshtë aludimin që ai të kishte konsumuar ndonjë substancë helmuese derisa ishte në banesën e z. A.

36. Më 28 janar 2008,SHPK-ja ia dha prokurorit informatat e azhurnuara rreth progresit të hetimit.

37. Më 31 janar 2008, prokurori i njëjtë publik kërkoi nga gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të lëshoj një urdhër për analizë të ADN-së në mostrat dhe dëshmitë e mbledhura nga mjekësia ligjore në vend të ngjarjes më 1 shkurt 2006 dhe gjatë autopsisë. Sipas prokurorit, analizat e tilla ishin të nevojshme për të konstatuar shkaktarin e vdekjes së E.A. Më 1 shkurt 2008, urdhri i kërkuar ishte dhënë.

38. Më 22 shkurt 2008, SHPK-ja e intervistoi znj. B. për herë të dytë, por nuk doli asnjë informatë e re.

39. Më 3 nëntor 2008, prokurori publik përgjegjës për rastin i ZPPQ në Prishtinë kërkoi nga laboratori i ZPZHML-së, që në ndërkohë ishte ndërtuar dhe ishte bërë operacional në mars të vitit 2007, të kryejë analizën e nevojshme toksikologjike. Megjithatë, në dosje nuk paraqitet asnjë veprim për sa i përket kësaj kërkese në atë kohë.

40. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

(EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

41. Më 19 mars 2009, i njëjti prokuror publik i paraqiti kërkesë tjetër ZPZHML së EULEX-it për analizë toksikologjike. Ankuesi deklaron se kjo kërkesë ishte paraqitur pasi ai kishte vazhduar me përcjelljen e rastit te prokurori dhe se ai personalisht ia kishte dorëzuar kërkesën e prokurorit ZPZHML-së, për të siguruar se ajo ishte pranuar në rregull.

42. Raporti i toksikologjisë i ZPZHML-së, i datës 30 mars 2009, dëshmoi praninë e një droge, që është përdorur zakonisht, në gjakun e E.A.; megjithatë, ai nuk e qartësonte shkaktarin e vdekjes.

43. Më 14 shtator 2009, prokurori kërkoi nga gjykatësi i procedurës paraprake të emërojë një ekspert për të vlerësuar raportin e autopsisë të datës 15 mars 2006 dhe raportin e toksikologjisë të datës 30 mars 2009, me qëllim të qartësimit të shkaktarit të vdekjes të E.A. Eksperti ishte emëruar në përputhje me rrethanat më 7 tetor 2009.

44. Më 15 dhjetor 2009, eksperti njoftoi se ky ekzaminim i ishte caktuar një grupi të ekspertëve, për ekzaminim kompleks ekspertësh. Më 23 dhjetor 2009, u caktua një ekip i përbërë nga katër ekspertë, një ekspert i mjekësisë ligjore, një toksikolog, një ekzaminues mjekësor i mjekësisë ligjore, dhe një farmakolog.

45. Më 5 korrik 2010, ekipi i ekspertëve e dorëzoi raportin e tyre. Ata deklaruan se e gjithë dëshmia e mbledhur deri tani tregonte që vdekja ishte shkaktuar nga intoksikimi (helmimi). Sipas ekspertëve, ka mundësi të madhe që shkaktari i drejtpërdrejtë i vdekjes së E.A. (shih § 27 më lart) ishte efekti toksik i reagimeve ndaj kombinimit të medikamenteve të ndryshme. Megjithatë, të gjeturat e tyre nuk ishin bindëse pasi niveli i substancave mjekësore në gjakun e të vdekurit nuk mund të konstatohej.

III. ANKESA

46. Ankuesi ankohet rreth dështimit të pretenduar të UNMIK-ut që të hetojë si duhet vdekjen e nipit të tij. Në lidhje me këtë, Paneli mendon që ankuesi mbështetet në shkeljen e obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së

1. Parashtresat e palëve

47. Ankuesi ankohet se rrethanat që ndërlidhen me vdekjen e nipit të tij akoma janë të papërcaktuara. Ai pohon që, sipas raportit të autopsisë, shkaktari i vdekjes mund të konstatohet vetëm përmes analizës toksikologjike; megjithatë, vonesa në marrjen e kësaj analize, që zgjati prej vitit 2006 deri më 2009, e rrezikoi mundësinë e autoriteteve për të konstatuar rrethanat që ndërlidhen me vdekjen.

48. Ankuesi deklaron se në disa raste ai e përcolli çështjen te patologu dhe ZPPQ përkitazi me gjendjen e hetimit. Ai shton se në mars të vitit 2009, për shkak të mosveprimit të autoriteteve relevante hetimore, ai duhej që personalisht ta dorëzonte kërkesën për analizë toksikologjike, nga ZPPQ te laboratori i mjekësisë ligjore. Ankuesi pohon se patologu dhe prokurori u sollën në mënyrë arrogante ndaj tij.

49. Ankuesi gjithashtu ankohet për atë se supozimi i hetuesve se, nipi i tij ishte një i varur nga droga nuk bazohet në dëshmi. Ai pohon se vdekja e nipit të tij mund të ketë ndodhur si rezultat i dhunës apo vrasjes së paramenduar, dhe se dëshmia për sa i përket kësaj nuk ishte shqyrtuar me kujdes nga hetuesit.

50. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja në fillim thekson se rasti në fjalë "është shumë i veçantë nga rastet ku një person ishte subjekt i dhunës së qartë dhe ishte vrarë si rezultat i dhunës së tillë" pasi vdekja e E.A. "duket të mos jetë e një natyre të tillë". PSSP-ja thotë se rrethanat e vdekjes së E.A. tregojnë për një vdekje të vetë-shkaktuar nga dobësimi akut i frymëmarrjes, e cila ishte konfirmuar nga prania e një substance narkotike në gjakun e të ndjerit (shih § 42 më lart). PSSP-ja thotë më tutje se pretendimet e ankuesit se vdekja e nipit të tij mund të ketë ndodhur si rezultat i dhunës nuk mbështeten nga autopsia (shih § 27 më lart).

51. Megjithatë, PSSP-ja nuk e konteston se UNMIK-u kishte për obligim sipas nenit 2 që të hetojë vdekjen e E.A. PSSP-ja konsideron që ankesa kryesisht është e drejtuar kundër ZPZHML së UNMIK-ut dhe deklaron se patologu i caktuar tregoi kujdes të duhur kur kreu autopsinë në trupin e E.A. Është e vërtetë se marrja e një analize të mëtejme toksikologjike me qëllim të përcaktimit të shkaktarit të vdekjes u rekomandua nga patologu, për shkak të mungesës së laboratorit të mjekësisë ligjore në Kosovë, i cili kishte filluar të funksionojë vetëm në mars të vitit 2007. Në lidhje me këtë, PSSP-ja i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkitazi me nenin 2 ku thuhet se obligimi për të hetuar nuk duhet të interpretohet në atë mënyrë që do të ngarkonte "barrë të papërballueshme dhe/apo joproporcionale" në autoritetet e përfshira.

52. Lidhur me veprimet e policisë, PSSP-ja deklaron që SHPK-ja ka kryer siç duhet një hetim për vdekjen e E.A. Ai e pranon se kishte vonesa të SHPK-së në përgjigje të kërkesave të prokurorit në atë që policia ndërmori veprimet e nevojshme "më së voni në dhjetor të vitit 2007"; megjithatë, ato periudha të "mosveprimit të mundshëm nuk mund të konsiderohen si të tejzgjatura, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta në terren në Kosovë."

53. Për këto arsye, PSSP-ja argumenton se nuk kishte shkelje të nenit 2 dhe se pretendimet kundër UNMIK-ut në këtë drejtim janë të pamerituara.

2. Vlerësimi i Panelit

54. Paneli konsideron që ankuesi thirret në shkeljen e obligimit procedural që rrjedh nga e drejta për jetë, e garantuar me nenin 2 të KEDNJ-së në atë që Policia e UNMIK-ut nuk kreu një hetim efektiv për vdekjen e nipit të tij.

a) Parimet e përgjithshme në lidhje me obligimin procedural sipas nenit 2

55. Me qëllim të trajtimit të akuzave të ankuesit, Paneli i referohet, në veçanti, praktikës gjyqësore të vërtetuar mirë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi obligimet procedurale sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata ka gjetur që "[o]bligimi për të mbrojtur të drejtën në jetë sipas nenit 2 të Konventës, shpallur në lidhje me detyrën e përgjithshme të

shtetit sipas nenit 1 të Konventës për t'i "siguruar secilit brenda juridiksionit [të vet] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [K]onventë", kërkon shprehimisht që duhet të ketë disa forma të hetimit zyrtar efektiv kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës" (shih, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës, 27 shtator 1995, § 161, seria A nr. 324; dhe *Kaya kundër Turqisë*, vendimi i gjykatës, 19 shkurt 1998, § 105, raportet 1998-I; shih gjithashtu GJEDNJ, *Jasinskis kundër Letonisë*, nr. 45744/08, vendimi i gjykatës, 21 dhjetor 2010, § 71). Gjykata ka gjetur më tutje që "obligimi për të kryer hetim efektiv zyrtar ekziston, gjithashtu, ku vdekja ndodh në rrethana të dyshimta që nuk u atribuohen agjentëve të shtetit" (shih GJEDNJ, *Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë*, nr. 25965/04, vendimi i gjykatës, 7 janar 2010, § 232; shih gjithashtu, GJEDNJ, *Menson kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendimi), nr. 47916/99, KEDNJ 2003-V; GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgarisë*, nr. 1108/02, vendimi i gjykatës, 5 nëntor 2009, § 191; GJEDNJ, *Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë*, nr. 55523/00, vendimi i gjykatës, 26 korrik 2007, §§ 92-93). Qëllimi esencial i një hetimi të tillë është të sigurojë implementim efektiv të ligjeve vendore, të cilat mbrojnë të drejtën në jetë dhe, në ato raste që përfshijnë agjentët apo organet e shtetit, të sigurojë përgjegjësinë e tyre për vdekjet që ndodhin nën përgjegjësinë e tyre. Gjykata Evropiane gjithashtu ka gjetur që autoritetet duhet të veprojnë vetë, sapo çështja të ketë arritur në vëmendjen e tyre, dhe ato nuk mund t'ia lënë atë iniciativës të të afërmit për të paraqitur ankesë formale apo të marrë përgjegjësinë për kryerjen e ndonjë procedure hetimore" (shih, mes tjerash, GJEDNJ, *Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë*, përmendur më lart, në § 232; GJEDNJ, *Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë*, përmendur më lart, § 96; GJEDNJ[DHL], *İlhan kundër Turqisë*, nr. 22277/93, § 63, KEDNJ 2000-VII; dhe GJEDNJ [DHL], *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 43577/98 dhe 43579/98, vendimi i gjykatës, 6 korrik 2005, § 111, KEDNJ 2005-VII).

56. Kur vendosen kërkesat e një hetimi të tillë, gjykata ka konsideruar se duhet të jetë e aftë të vërtetojë shkakun e lëndimeve dhe identifikimin e atyre që janë përgjegjës me synim dënimin e tyre. (GJEDNJ, *Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë*, përmendur më lart, § 94).Ndërsa obligimi për të hetuar nënkupton vetëm përdorimin e mjeteve të duhura dhe nuk ekziston asnjë e drejtë absolute të arrihet deri te ndjekja penale apo dënimi, autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapash të arsyeshëm për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin, duke përfshirë ndër të tjera dëshmitë e dëshmitarit okular, dëshmitë e mjekësisë ligjore dhe, ku është e nevojshme, një autopsi e cila siguron të dhëna të plota dhe të sakta për lëndimin dhe një analizë objektive të të gjeturave klinike, duke përfshirë shkaktarin e vdekjes. Çdo e metë në hetim e cila rrezikon aftësinë për të vërtetuar shkaktarin e vdekjes ose personin apo personat përgjegjës, do të rrezikojë të jetë si parregullsi sa i përket këtij standardi (shih GJEDNJ, *Angelova dhe Iliev kundër Bullgarisë*, përmendur më lart, § 95; GJEDNJ[DHL], *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, përmendur më lart, § 113; dhe GJEDNJ, *Ognyanova dhe Choban kundër Bullgarisë*, nr. 46317/99, vendimi i gjykatës, 23 shkurt 2006, § 105). Megjithatë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit, të cilat plotësojnë pragun minimal të efektivitetit të hetimit, varen nga rrethanat e rastit të veçantë. Ato duhen vlerësuar në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore (shih GJEDNJ, *Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, vendimi i gjykatës, 1 dhjetor 2009, § 105)).

57. Një kërkesë për shpejtësi dhe ekspeditivitet të arsyeshëm është e nënkuptueshme në kontekstin e një hetimi efektiv në kuadër të kuptimit të nenit 2 (shih GJEDNJ, *Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë*, përmendur në § 55 më lart, në § 233, dhe rastet e përmendura aty). Në të gjitha rastet duhet pranuar se mund të ketë pengesa apo vështirësi të cilat e pengojnë progresin në një hetim dhe në një situatë të veçantë.

58. Gjykata Evropiane ka shpallur më tutje që duhet të ketë elemente të mjaftueshme të shqyrtimit publik të hetimit apo rezultateve të tij për të siguruar përgjegjësi në praktikë dhe në teori. Shkalla e shqyrtimit të kërkuar publik mundet të ndryshojë mjaft nga rasti në rast. Në të gjitha rastet, megjithatë, i afërmi i viktimës duhet të jetë i përfshirë në procedurë deri në shkallën që mbron interesat e tij legjitime (shih GJEDNJ, *Rantsev kundër Qipros dhe Rusisë*, përmendur më lart, *ibid*.).

a) Pajtueshmëria me nenin 2 në rastin aktual

59. Në fillim, Paneli thekson që PSSP-ja deklaron se vdekja e E.A. "duket" të mos jetë e një natyre që nënkupton përdorimin e dhunës, megjithëse ai nuk e konteston në mënyrë të qartë ekzistencën e obligimit të UNMIK-ut që të hetojë vdekjen e tij. Në lidhje me këtë, Paneli konsideron se obligimi sipas nenit 2 zgjerohet në rastet e vdekjeve të cilat kanë ndodhur në rrethana të dyshimta. Pasi merr parasysh faktet, sikur rrethanat e pasqaruara që ndërlidhen me vdekjen e tij (të treguara, në mënyrë kritike, nga hetuesit të jenë "të dyshimta"), dhe gjithashtu paaftësinë e ekspertëve që të përcaktojnë pa mëdyshje shkaktarin e vdekjes së tij, Paneli konsideron se autoritetet hetimore ishin të obliguara të kryejnë hetim efektiv për vdekjen e E.A.

60. Ankuesi ankohet se veprimet e kryera nga UNMIK-u për të hetuar vdekjen e nipit të tij ishin joadekuate. Në veçanti ai pretendon se kishte vonesë të paarsyeshme në kryerjen e analizës toksikologjike pas autopsisë dhe që autoritetet hetimore nuk ndoqën të gjitha pistat e hetimit në lidhje me vdekjen e nipit të tij. Ankuesi ankohet më tutje se ai nuk kishte qasje të duhur në hetim.

61. Paneli thekson se hetimi për rastin e E.A. ishte nisur po të njëjtën ditë të vdekjes së tij, 1 shkurt 2006, dhe akoma është në zhvillim e sipër. Megjithatë, periudha nën juridiksionin e Panelit përfundon më 9 dhjetor 2008 (shih § 40 më lart).

62. Për sa i përket kërkesave për shpejtësi dhe ekspeditivitet, Paneli përsëri thekson se hetimi filloi po të njëjtën ditë të vdekjes së E.A. dhe se një sërë hapash esencialë hetimorë ishin ndërmarrë nga autoritetet hetimore menjëherë pas vdekjes së tij. Në veçanti, menjëherë pasi ishte raportuar vdekja e tij, disa ekipe policore, duke përfshirë ekipin e mjekësisë ligjore, shkuan në vendin e ngjarjes; u bënë fotografi si dhe u mblodhën dëshmi dhe mostra. Policia pa vonesë intervistoi tre dëshmitarët e identifikuar. Pasi vdekja ishte"e dyshimtë", ishte kryer një autopsi e plotë nga patologu ditën vijuese, më 2 shkurt 2006. Raporti i autopsisë, i lëshuar më 15 mars 2006, ofroi një analizë të detajuar të të gjeturave klinike, identifikoi shkaktarin e drejtpërdrejtë të vdekjes dhe atë që më së shumti ka të ngjarë të jetë arsyeja e saj (keqpërdorimi i drogave).

63. Në muajin maj të vitit 2006, ishin shqyrtuar pista të tjera të hetimit nga hetuesit (shih § 32 më lart); Z. A ishte intervistuar si i dyshuar dhe znj. B ishte ri-intervistuar si dëshmitare, por nuk doli asnjë pistë tjetër hetimi nga ai aktivitet (shih § 35 dhe 38 më lart).

64. Paneli thekson se kishte të meta dhe vonesa në hetim për sa i përket shqyrtimit të disa dëshmive të mbledhura. Në veçanti, siç thekson ankuesi, analiza toksikologjike që ishte rekomanduar nga patologu në muajin mars të vitit 2006, ishte kryer vetëm në muajin mars të vitit 2009, nën autoritetin e EULEX-it. Përveç kësaj, Paneli thekson se në disa raste (shkurt dhe mars 2006, tetor 2007) prokurori përgjegjës për rastin nga ZPPQ në Prishtinë kërkoi nga SHPK-ja të ndërmarrë aktivitete shtesë, duke përfshirë testin e ADN-së, në lidhje me dëshmitë e mbledhura. Megjithatë, nuk kishte përgjigje ndaj këtyre kërkesave deri në janar të vitit 2008.

65. PSSP-ja argumenton që neni 2 nuk duhet interpretuar ashtu që t'u ngarkojë një barrë "joproporcionale" apo "të papërballueshme" autoriteteve hetimore dhe që, duke pasur parasysh "rrethanat e veçanta në terren në Kosovë", duke përfshirë mungesën e një laboratori të toksikologjisë në kohën e vdekjes së E.A., këto vonesa nuk mund të konsiderohen të tepërta.

66. Paneli tanimë ka konsideruar se ajo që arrin të bëhet barrë e papërballueshme dhe/apo joproporcionale duhet të matet nga faktet dhe kontekstet e rastit (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, *Tomanoviq dhe të tjerët*, nr. 248/09 dhe të tjerët, mendimi i 23 prillit 2013§ 70; shih gjithashtu GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, nr. 4704/04, vendimi i gjykatës, 15 shkurt 2011, § 70; GJEDNJ, *Brecknell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32457/04, vendimi i gjykatës, 27 nëntor 2007, § 62). Pasi vlerëson aktivitetin e zhvilluar nga hetuesit menjëherë pas incidentit, si dhe pamundësinë e kryerjes së analizës toksikologjike në Kosovë deri së paku në muajin mars të vitit 2007, dhe gjithashtu pjesën e kufizuar të hetimit që bie nën juridiksionin e vet të përkohshëm, Paneli konsideron se vonesat e lartpërmendura nuk janë të tepërta duke pasur parasysh rrethanat e rastit.

67. Për sa u përket pretendimeve të ankuesit se hetimi nuk ishte adekuat duke u bazuar në atë se nuk ishin ndjekur të gjitha pistat e hetimit, Paneli, përsëri, thekson se vdekja e E.A. ishte konsideruar në mënyrë të drejtë si e dyshimtë. Megjithatë, në raportin e autopsisë autoriteteve hetimore u aludohej fuqishëm se vdekja e E.A. me siguri nuk i ishte shkaktuar atij. Paneli gjithashtu thekson se, megjithëse me pak vonesë, të gjitha pistat e tjera hetimore në dispozicion ishin shqyrtuar. Megjithatë, nuk u zbulua asnjë dëshmi shtesë që aludonte se vdekja e tij ishte shkaktuar nga një vepër e kryer penale. Për këtë arsye, Paneli konstaton se hetimi, i marrë si i plotë, nuk mund të konsiderohet joefektiv sipas kuptimit të nenit 2 të KEDNJ-së.

68. Për sa i përket deklaratës së ankuesit se autoritetet hetimore kishin pasur një sjellje arrogante ndaj tij dhe që për atë arsye hetimi nuk ishte i qasshëm për të, Paneli vëren në parashtresat e ankuesit se ai ishte informuar rreth gjendjes së hetimit, në veçanti se hetimi ishte në një rrugë qorre për shkak të mungesës së analizës toksikologjike, deri në atë pikë saqë ai u dorëzoi në disa raste kërkesë autoriteteve për të shtyrë përpara atë proces. Për këtë arsye, Paneli konstaton se ankuesi, si i afërm i E.A., ishte i përfshirë mjaftueshëm në hetim dhe ai gjithashtu nuk gjen asnjë shkelje të kërkesës që një hetim të jetë i hapur për shqyrtim publik.

69. Prandaj, Paneli përfundon se në rastin aktual nuk ka pasur shkelje të nenit 2, obligimi procedural, të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT PROCEDURAL SIPAS NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.

Andrey ANTONOV	Marek NOWICKI
Zyrtar ekzekutiv	Kryesues